



Në mbështetje të Nenit 4 dhe 23 të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (Nr. 03/L-189, datë 16. 09. 2010), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative (Nr. 05/L-031, datë 25. 05. 2016), Nenit 7 dhe 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29. 08. 2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 15/2018, datë 28. 09. 2018), Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KShC), në mbledhjen e 61-të, të mbajtur më 15 dhe 16 janar 2019, mori:

V E N D I M

- I. Refuzohet pjesërisht kërkesa e Universitetit të Prizrenit "Ukshin Hoti", Nr.1367/18H, datë 22.10.2018 për riakreditim/akreditim të programeve të studimit:
 - Teknologji Informative dhe Telekomunikim, BSc, 180 ECTS, (në gjuhët shqipe, turke dhe boshnjake), dhe
 - Gjuhë dhe Letërsi Gjermane, BSc, 240 ECTS.
- II. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetimi

Universiteti i Prizrenit "Ukshin Hoti", ka parashtruar kërkesë (kërkesa Nr.1367/18H, datë 22.10.2018) në Agjencinë e Kosovës për Akreditim për riakreditim dhe akreditim të programeve të studimit si në vijim: Administrim Biznesi, BSc, 180 ECTS; Menaxhment Ndërkombëtar, BSc, 180 ECTS; Juridik, LLB 240 ECTS; Dizajn Softveri, BSc, 180 ECTS; Teknologji Informative dhe Telekomunikim, BSc, 180 ECTS; (në gjuhët: shqipe, turke dhe boshnjake); Gjuhë dhe Letërsi Gjermane, BSc, 240 ECTS, dhe Kushtetues-Administrativ, LLM, 60 ECTS.

Bazuar në Nenin 10 të Udhëzimit Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë, Nr. 15/2018, datë 28.09.2018, (tash e tutje UA për Akreditim), KShC në mbledhjen e mbajtur me 15 dhe 16 janar 2019 ka trajtuar aplikacionin e Universitetit të Prizrenit "Ukshin Hoti" (tash e tutje Universiteti), dhe pas analizës së dokumentacionit të stafit akademik bazuar në pikën 1.2 të këtij Nenit 10 të UA për Akreditim, thuhet, "Në përputhje me kërkesat e këtij udhëzimi administrativ, KShC do të bëjë aprovimin e listës së stafit akademik për çdo program të studimit i cili parashtrohet për aplikim nga institucionet e arsimit të lartë. Tabelat e plotësuara në formë elektronike se bashku me deklaratat për angazhimin e stafit akademik përcillen në formë të raportit përmbledhës në mbledhjen e ardhshme të KShC-së për aprovim formal. Raporti

përmbledhës për gjendjen e stafit në bazë të të dhënave të dorëzuara nga institucionet e arsimit të lartë përgaditët nga stafi i AKA-së”, erdhi në përfundim se programet e studimit Teknologji Informative dhe Telekomunikim, BSc, 180 ECTS, (në gjuhët shqipe, turke dhe boshnjake), Gjuhë dhe Letërsi Gjermane, BSc, 240 ECTS, nuk i plotësojnë kushtet ligjore për aprovim nga KShC.

Bazuar në Nenin e referuar më lartë, KShC në mbledhjen e mbajtur më 15 dhe 16 janar 2019 ka trajtuar aplikacionin e dorëzuar nga Universiteti i Prizrenit. Sipas të dhënave të prezantuara nga raporti përmbledhës për programet me të cilat ka aplikuar ky institucion, dhe pas analizimit të detajuar të dokumentacionit të prezantuar nga ky institucion për stafin akademik, KShC aprovoi pjesërisht kërkesën për këtë aplikacion, dhe në mungesë të stafit akademik të fushës së programit të studimit, ashtu siç parashihet me Nenin 26, pika 5.3.4 e UA për Akreditim, dhe bazuar në Nenin 10, pika 1.3.2, KShC mori vendim për refuzim të aprovimit të aplikacionit për programet e studimit si në vijim: Teknologji Informative dhe Telekomunikim, BSc, 180 ECTS, (në gjuhët shqipe, turke dhe boshnjake), Gjuhë dhe Letërsi Gjermane, BSc, 240 ECTS.

Sipas Nenit 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim (15/2018, datë 28.09.2018), Institucionet e Arsimit të Lartë: *“Për programet e studimit të cilat shpijnë deri tek marrja e një diplome shkencore Bachelor dhe Master, kërkesat për stafin akademik janë për çdo grup të studentëve (të përcaktuar sipas statutit të IAL) dhe për çdo 60 ECTS kredi të programit studimit, institucioni duhet të ketë të paktën një (1) staf me marrëdhënie të rregullt të punës me titull PhD nga fusha e programit të studimit”.*

1. Për programin e studimit: *Teknologji Informative dhe Telekomunikim, BSc, 180 ECTS*, (në gjuhët shqipe, turke dhe boshnjake), si bartës të këtij programi Universiteti i Prizrenit ka paraparë këta persona: Arsim Susuri (PhD në Shkenca Kompjuterike), Naim Baftiu (PhD në Shkenca Teknikë), Malush Mjaku (PhD në Shkenca Teknikë).

Sipas paragrafit të fundit të Nenit 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim, kërkohet që: *“për çdo 60 ECTS kredi të programit studimit, institucioni duhet të ketë të paktën një (1) staf me marrëdhënie të rregullt të punës me titull PhD nga fusha e programit të studimit”.* Programi i studimit *Teknologji Informative dhe Telekomunikim, BSc, ka 180 ECTS*, andaj duhet të ketë të paktën tre persona me gradën akademike PhD, nga fusha e programit të studimit.

Pas verifikimit të dokumentacionit të stafit akademik të prezantuar nga ky institucion për këtë program të studimit, është konstatuar që asnjëri nga bartësit e këtij programi të studimit nuk i përkasin fushës së programit *Telekomunikim*, dhe mbi këtë bazë vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Meqenëse ky program ofrohet në të njëjtën kohë edhe në gjuhët e dy komuniteteve, turke dhe atë boshnjake, kjo çështje trajtohet sipas Nenit 26, pika 5.3.10 e UA për Akreditim. Sipas kësaj pike: *“Programet e studimit në gjuhët e komuniteteve (boshnjake dhe turke) në universitetet publike të Republikës së Kosovës të ofruara deri me tani, të cilat kanë mungesë të stafit akademik me gradën Dr.sc., ashtu siç është përcaktuar me këtë UA, do të lejohen të ofrohen paralelisht me programet e akredituara në gjuhën shqipe, me kusht që brenda periudhës kalimtare prej pesë (5) vitesh, këto institucione të ngrisin kapacitetet vetanake të cilat sigurojnë qëndrueshmërinë e ofrimit të programit të studimit, sipas kërkesave të mësipërme të këtij UA”.*

Meqenëse ky program është refuzuar për aprovim të aplikacionit në gjuhën shqipe, dhe bazuar në pikën 5.3.10 të referuar më lartë, në mungesë të stafit akademik në gjuhën shqipe sipas pikës 5.3.4 të nenit 26, KShC, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Bazuar në faktet e prezentuara më sipër dhe dispozitat ligjore të sqaruara më lartë, KShC vendosi që në mungesë të stafit të fushës së programit të studimit të refuzoj aprovimin e aplikacionit për programin e studimit *Teknologji Informativ dhe Telekomunikim, BSc, 180 ECTS*.

2. Për programin e studimit: *Gjuhë dhe Letërsi Gjermane, BSc, 240 ECTS* si bartës të këtij programi Universiteti ka paraparë katër persona: Kimete Canaj (PhD në Filologji), Izer Maksuti (PhD në Lingusitikë), Ragip Gjoshi (PhD në Kërkime Gjuhësore) dhe Ilir Krusha (nuk ka deklarim në e-akreditim).

Sipas paragrafit të fundit të Nenit 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim, kërkohet që: *“për çdo 60 ECTS kredi të programit studimit, institucioni duhet të ketë të paktën një (1) staf me marrëdhënie të rregullt të punës me titull PhD nga fusha e programit të studimit”*. Programi i studimit: *Gjuhë dhe Letërsi Gjermane, BSc, 240 ECTS*, kredi, dhe rrjedhimisht duhet të ketë të paktën 4 PhD nga fusha e programit të studimit.

Pas verifikimit të dokumentacionit të stafit akademik të prezantuar nga ky institucion për këtë program të studimit, është konstatuar që Ilir Krusha nuk ka marrëdhënie të rregullt të punës, në Universitetin e Prizrenit pasi që i njëjti nuk ka kontratë pune, dhe i njëjti nuk është i deklaruar sipas nenit 30 të UA për Akreditim. Sipas pikës një (1) të Nenit 30 të Udhëzimit Administrativ për Akreditim, *“IAL-të, duhet të dorëzojnë deklaratat e stafit akademik të angazhuar jo më larg se data 31 tetor”*, pra IAL ka qenë i detyruar që të deklaroj stafin akademik më së largu deri më 31 tetor 2018. Derisa i njëjti nuk ka marrëdhënie të rregullt të punës (pra nuk ka kontratë pune) dhe nuk është i deklaruar sipas afateve ligjore, i njëjti nuk mund të pranohet si staf akademik dhe nuk mund të jetë bartës i këtij programi të studimit.

Ndërsa Izer Maksuti nuk është shtetas i Republikës së Kosovës, dhe i njëjti duhet të dorëzoj dëshmi sipas pikës pesë (5) të nenit 30 të UA për Akreditim. Sipas pikës, *“Për qëllim të akreditimi, stafi akademik të cilët nuk janë shtetas të Republikës së Kosovës, duhet të posedojnë leje qëndrim dhe leje të punës në Republikën e Kosovës. Po ashtu ky staf akademik duhet të sjellë dëshmi nga institucioni relevant nga vendi i origjinës (p.sh. Administrata Tatimore) që nuk ka marrëdhënie të rregullt të punës në vendin e origjinës”*. Bazuar në dispozitën e referuar më lartë dhe faktin që një dëshmi e tillë nuk është dorëzuar në AKA, ky staf nuk mund të jetë bartës i programit të studimit, pasi që nuk plotëson kriteret e parapara me Nenin 30 të UA për Akreditim.

Bazuar në faktet e prezentuara më sipër dhe dispozitat ligjore të sqaruara më lartë, KShC vendosi që në mungesë të stafit të fushës së programit të studimit, dhe bazuar në Nenin 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim, të refuzoj aprovimin e aplikacionit për programin e studimit *Gjuhë dhe Letërsi Gjermane, BSc, 240 ECTS*.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqes ankesë sipas Nenit 125 dhe 126, të Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative (Nr. 05/L-31, datë 25 maj 2016). Ankesa kundër këtij

akti administrativ i dorëzohet organit i cili e ka nxjerr këtë vendim bazuar në Nenin 128 të LPPA, në afatin prej 30 nga dita kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas Nenit 127 të LPPA.

Vendimi iu dërgohet:

- Universiteti i Prizrenit "Ukshin Hoti";
- MASHT-it;
- Arkivit të AKA-së.

G. Luboteni

Prof. Dr. Gazmend Luboteni
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë

